

***AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“OLSI-A 2022“ sh.p.k.***

Në Tiranë, sot më datë 10/10/2022 :

**Z. Olsi Beshku**, shtetas Shqiptare, lindur ne Burrel, më 12/11/1991 dhe banues ne Tirane në adresën Rr. Astir, Pallati Vila L, Kati 6, Ap.nr. 21, mbajtëse e pasaportës me ID. J11112060C,

Në cilësinë e “ortakut themelues” ka rene dakort per hartimin e ketij akt themelimi , nëpëmjet të cilit deklarojne se me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqerinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, **“OLSI-A 2022“ sh.p.k**

*KREU I*

*Neni 1*  
*Krijimi*

Shoqeria **“OLSI-A 2022“ sh.p.k.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Pergjegjësi te Kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

*Neni 2*  
*Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **“OLSI-A 2022“ sh.p.k.**, është një shoqëri tregtare me perqejjesi te kufizuar.

*Neni 3*  
*Selia*

Shoqëria e ka selinë ne Autostradën Tiranë-Durrës, Km. 6, Magazina Viktoria, Kashar, Tiranë-Shqipëri. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetem nga Administratoret si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

*Neni 4*  
*Objekti i veprimitarisë*

Sherbimi taksi, tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport te mallrave industriale, konfeksione, kozmetike, buzhuteri, lende te pare per industrine, materiale dhe paisje te ndryshme. Blerjen me qellim te furnizoje me mallra, konfeksione, veshmbathje, kozmetike, buzhuteri, dhe lende te pare per industrine, ne bashkepunim me shoqeri vendase dhe te huaja si dhe import-eksportin e mallrave te ndryshme qe do te jene objekt i aktivitetit tregetar. Trasport kombetar dhe nderkombetar, per nevoja te vete shoqerise dhe per te trete. Te kryeje publikime dhe aktivitete reklamuese. Pjesemarrjen dhe organizimin e ekspositave, panaireve dhe /ose aktiviteteve te ngjashme, brenda dhe jashte vendit. Qiramarrjen, qiradhenien dhe leasing te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, mallrave dhe produkteve per realizimin e qellimit kryesor te shoqerise. Te kontrakoje me persona fizike dhe juridike vendas e te huaj, per gjetjen



e tregjeve te reklamimit dhe te shitjes se produkteve te shoqerise. Te fitoje, direkt apo indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje objekt te ngjashem me ate te Shoqerise , ne Shqiperi ose jashte saj. Shoqeria gjithashtu mund te realizoje cdo aktivitet te ligjshem tjeter te cilin ajo e cmon te nevojshem per realizimin e qellimeve te saj.

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

*KREU II  
KAPITALI*

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë. Kapitali i shoqërisështë i përbërë nga 1 kuotë me vlerë, si me poshtë:

**Z.Olsi Beshku**, zoterues e 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërise me vlere 100 000 (Njeqind mijë) lek , ;

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërise.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU II**  
**ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8  
Organë Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria eshte e themeluar nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

*Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:*

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 9  
Administrimi

Administratore Ishoqerise eshte **Olsi Beshku** Iemëruar në këtë detyrëpër një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 10  
Kompetencat

*Administratori ka te drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet aktave që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë finansiar qëfillon nga data e regjistrimit të shoqerisë në QKR dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 12



### Shperndarja ose prishja e shoqerisë

Shperndarja ose prishja e shoqerisë mund të behet nëçdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar nëçdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoperi në likuidim e sipër ".

### Neni 13

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themeli dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themeli, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqiperisë.

### Neni 14

#### Dispozita përfundimtare

Ky akt themeli u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themeluesi shoqërisë tregtare "OLSI-A 2022" sh.p.k, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orginale.

### ***ORTAKU I SHOQERISE***

**Olsi Beshku**

*Olsi Beshku*